



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**KGJK.nr.102/2022**  
**Datë: 24 shkurt 2022**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragrafi 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Musa Konxheli, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/09/2021/GJTHPR-AD/GJTHPR/40/21, të datës 26 janar 2022, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenin 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në vazhdimin e seancës dëgjimore të mbajtur me 24 shkurt 2022, nxjerr këtë:

#### V E N D I M

1. Musa Konxheli, gjyqtar i Gjykatës Themelore në Prishtinë, është përgjegjës për shkelje disiplinore, të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe pikën 5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë.
2. Për këtë shkelje disiplinore, gjyqtarit Musa Konxheli i shqiptohet sanksioni disiplinor **vërejtje publike me shkrim.**

#### A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (më tutje “Këshilli”), më 05.11.2021 ka pranuar kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor nga Autoriteti Kompetent me pretendimin se Musa Konxheli, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, mund të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nga pika 5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë. Autoriteti Kompetent ka kërkuar nga Këshilli, si organ kompetent, të fillojë hetimin disiplinor dhe ka propozuar që ndaj të njëjtit, në rast se vërtetohet se ekziston shkelja disiplinore, t’i shqiptohet njëra nga sanksionet disiplinore të parapara sipas nenit 7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Kërkesës së cekur më lartë, Autoriteti Kompetent ia ka bashkangjitur shkresat e lëndës të evidentuar me numër PKR.nr.35/15, në bazë të të cilave pretendon se ka pasur neglizhencë në vendosjen e lëndës përkatëse dhe zvarritje të procedimit të lëndës si pasojë e mosveprimit të gjyqtarëve që kanë qenë të ngarkuar me këtë lëndë. Nga Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë janë trajtuar vetëm veprimet e gjyqtarit Musa Konxheli e jo të gjyqtarëve të tjerë, pasi që i njëjti nga 01.07.2019 është gjyqtar i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special.

Këshilli, me vendimin KGJK.nr.323/2021, të datës 08.11.2021, ka themeluar Panelin Hetimor për lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/09/2021/GJTHPR-AD/GJTHPR/40/21. Paneli Hetimor, më 26.01.2022 i ka paraqitur Këshillit raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkeljen e pretenduar.

Pas pranimit të raportit nga Paneli Hetimor, për të shqyrtuar këtë çështje disiplinore, Këshilli më datë 10.02.2022, ka mbajtur seancë dëgjimore, ku morën pjesë Kryesuesi i Panelit Hetimor, gjyqtari Gazmend Sylaj, dhe subjekti i hetimit disiplinore, gjyqtari Musa Konxheli.

Kryesuesi i Panelit Hetimor, bazuar në Ligjin Nr.06/l-057 për Përgjegjësën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore më datë 8 dhjetor 2021, në të cilën është ftuar subjekti i hetimit disiplinor.

Paneli Hetimor, më datë 22.11.2021, i është drejtuar Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe ka kërkuar shënimet mbi ngarkesën me lëndë të gjyqtarit Musa Konxheli për periudhën kohore nga janari 2016 deri në korrik 2019.

Faktet e gjetura nga Paneli Hetimor janë se subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Musa Konxheli, është ngarkuar më lëndën kontestuese PKR.nr.35/15, me datë 06.03.2015. Gjyqtari Konxheli seancën e parë për këtë çështje penale e kishte caktuar me datë 02.02.2016. Për shkak se nuk ka mundur të sigurohet pjesëmarrja e të pandehurve në procedurë edhe përkundër faktit se ju ishin dërguar ftesat të pandehurve, seanca nuk është mbajtur. Nga fletë kthesat e dërguara ishte konstatuar se të pandehurit A.S. dhe G.P. nuk banojnë në adresat në të cilat iu janë dërguar ftesat, kurse për të pandehurin M.S. në fletë kthesë është konstatuar se i njëjti është shpërngulur nga adresa ku ka jetuar.

Nga data 02.02.2016 deri më 26.01.2017, gjyqtari Konxheli nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim tjetër lidhur me caktim e seancës. Veprimin e dytë dhe të fundit lidhur më këtë çështje penale gjyqtari Konxheli e kishte ndërmarrë kur i është drejtuar Stacionit Policor në Zveçan. Më datë 26.01.2017, Stacioni Policor në Zveçan e ka njoftuar Gjykatën Themelore në Ferizaj se personi G.P. që nga pas lufta jeton në Mitrovicë. Po ashtu, sipas kërkesës së gjyqtarit Konxheli, më 06.02.2017 Stacioni Policor në Ferizaj njofton Gjykatën Themelore në Ferizaj se adresa e të pandehurit A.S. është në Ferizaj, por i njëjti me tërë familjen gjendet në Suedi.

Gjyqtari Konxheli, nga 15.03.2017 deri më 01.07.2019, ka qenë i përzgjedhur si gjyqtar mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në Ferizaj - Dega në Shtërpcë. Nga data 01.07.2019, gjyqtari Konxheli ka kaluar në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Special.

Për periudhën përkatëse, Paneli Hetimor ka siguruar vlerësimin e punës për gjyqtarin Konxheli. Sipas të gjeturave të Panelit Hetimor, arsyetimi për këtë zvarritje të çështjes penale në fjalë nagane e gjyqtarit Konxheli ka qenë mbingarkesa e tij me lëndë. Nga muaji mars 2017, gjyqtari Konxheli është caktuar si gjyqtar mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në Ferizaj - Dega në Shtërpcë, e cila gjykatë fillimisht ka qenë e pa organizuar dhe përveç punës si gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, atij i është dashur të merret edhe me punët e Degës së Shtërpcës. Në këtë periudhë kohore, sipas të gjeturave të Panelit Hetimor, gjyqtari Konxheli ka qenë i angazhuar në cilësinë e anëtarit të Kolegjit edhe me lëndë të EULEX-it, për të cilat lëndë janë mbajtur me qindra seanca. Këto kanë qenë kryesisht të krimit të organizuar, terrorizmit etj.

Subjekti i hetimit kishte deklaruar para Panelit Hetimor se gjatë periudhës përkatëse atij i është dashur që të angazhohet në kryerjen e lëndëve që lidhen me plotësimin e kushteve për liberalizim të vizave. Sipas udhëzimeve të KGJK-së, këtyre lëndëve iu është dhënë prioritet. Në këtë kohë, gjyqtari Konxheli ka qenë i ngarkuar me gjithsej 240 lëndë në Gjykatën Themelore në Ferizaj, ndërsa në Degën e Shtërpcës me 257 lëndë.

Në fund të seancës dëgjimore, Kryesuesi i Panelit Hetimor deklaroi se arsyeja e vonesës në procedim të lëndës penale përkatëse, e evidentuar me numër PKR.nr.35/15, ka qenë mbingarkesa me lëndë. Ndërsa, çështja e moslëshimit të flet rreshtimit sipas Kryesuesit të Panelit Hetimor është e lidhur me interpretimin e dispozitës përkatëse të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Paneli Hetimor, raportit mbi faktet dhe provat e mbledhura ja ka bashkangjitur një shkresë të datës 7.10.2021, të Kryetarit të Gjykatës Supreme për Kryetarin e Gjykatës Themelore në Prishtinë; Shënimin zyrtar PPKR.nr.35/2015, të datës 25 gusht 2021; shkresën e datës 25 gusht 2021; Shkresën e datës 24 gusht 2021, me referencë GJA.nr.185/2021, nga ushtrues i detyrës së Kryetarit të Gjykatës në atë periudhë; Shkresën e regjistrimit elektronik të lëndëve me shenjen 4 prej 36646 është në renditje, bashkangjitur me raportin në dorëshkrim të lëndëve; Aktakuzën PKR.nr.35/2015; Aktvendimin PPKRK.43/13, datë 02.08.2013; Propozimin për zëvendësimin e masës së paraburgimit me masën e arrestit shtëpiak PP.I-110/2013, të datës 31.07.2013; Aktvendimin PPKR.nr.43/13; Kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit, PPI.110/213, të datës 12.07.2012; Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, numri i lëndës 2018:041269, datë 19.02.2020; Raportin e vlerësimit të performancës; Transkriptin e seancës dëgjimore të datës 08 dhjetor 2021, të panelit hetimor; Procesverbalin mbi paraburgimin PPKR.nr.43/13, 12.07.2013, Ferizaj; Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj PPrKR.nr.43/13, datë 12.07.2013; Vendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, datë 12.07.2013, numri i dosjes 004348/21; Kërkesën për përjashtimin nga lënda 2018:041269, datë 07.02.2020, bashkangjitur me vendimet përkatëse për përjashtim dhe deklaratën e gjyqtarit Musa Konxheli, Departamenti special, sipas kërkesës 12 tetor 2021 për Kryetaren e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Gjyqtari Konxheli në fillim të deklaratës së tij të dhënë gjatë seancës dëgjimore të mbajtur më 10.02.2022 në Këshill, deklaroi se nuk e kundërshton raportin e prezantuar nga Kryesuesi i Panelit Hetimor, por kundërshton në tërësi iniciimin e procedurës disiplinore për rastin konkret. Ai deklaroi se iniciimi i kësaj procedure disiplinore ka të bëjë me periudhën kohore 2015-2019, gjatë të cilës periudhe ka pasur një plan pune nga Këshilli ku iu ishte kërkuar gjyqtarëve të departamenteve të krimeve të rënda të fokusohen në lëndët me prioritet. Gjyqtari Konxheli deklaroi se atij gjithmonë i janë ndarë lëndët më të vështira dhe më të ndërlikuara. Po ashtu, ai deklaroi se në këtë periudhe ka qenë i angazhuar edhe në lëndë të EULEX-it në cilësinë e anëtarit të kolegjit.

Gjyqtari Konxheli deklaroi se caktimi i tij si gjyqtar mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në Ferizaj - Dega në Shtërpcë gjatë periudhës përkatëse e ka rritur ngarkesën e tij në punë. Ai deklaroi se paradite ka punuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, ndërsa pasdite ka qëndruar në Degën në Shtërpcë. Lidhur me mos lëshimin e flet arrestit për çështjen penale përkatëse, të evidentuar me numër PKR.nr.35/15, gjyqtar Konxheli vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet sipas nenit 175 të KPPK-së për të lëshuar flet arrestin.

Sipas gjyqtarit Konxheli është evidente që ka pasur vonesë në procedimin e çështjes penale përkatëse në fjalë, por kjo ka ardhur si pasojë e mbingarkesës së tij me lëndë të rënda penale.

Për t'i vërtetuar faktet në këtë çështje disiplinore, Këshilli administroi dhe vlerësoi këto prova: një shkresë të datës 07.10.2021, të Kryetarit të Gjykatës Supreme për Kryetarin e Gjykatës Themelore në Prishtinë; Shënimin zyrtar PPKR.nr.35/2015, të datës 25 gusht 2021; Shkresën e datës 25 gusht 2021; Shkresën e datës 24 gusht 2021, me referencë GJA.nr.185/2021, nga

ushtrues i detyrës së Kryetarit të Gjykatës në atë periudhë; Shkresën e regjistrimit elektronik të lëndëve me shenjen 4 prej 36646 është në renditje, bashkangjitur me raportin në dorëshkrim të lëndëve; Aktakuzën PKR.nr.35/2015; Aktvendimin PPKRK.43/13, datë 02.08.2013; Propozimin për zëvendësimin e masës së paraburgimit me masën e arrestit shtëpiak PP.I-110/2013, të datës 31.07.2013; Aktvendimin PPKR.nr.43/13, kërkesën për caktimin e masës së paraburgimit, PPI.110/213, të datës 12.07.2012; Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, numri i lëndës 2018:041269, datë 19.02.2020; Raportin e vlerësimit të përfundimit; Transkriptin e seancës dëgjimore të datës 08 dhjetor 2021, të panelit hetimor; Procesverbalin mbi paraburgimin PPKR.nr.43/13, 12.07.2013, Ferizaj; Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj PPKR.nr.43/13, datë 12.07.2013; Vendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, datë 12.07.2013, numri i dosjes 004348/21; Kërkesën për përjashtimin nga lënda 2018:041269, datë 07.02.2020, bashkangjitur me vendimet përkatëse për përjashtim; Deklaratën e gjyqtarit Musa Konxheli, Departamenti special, sipas kërkesës 12 tetor 2021 për Kryetaren e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Pas vlerësimit të provave të administruara dhe deklaratës së subjektit të hetimit, Këshilli në vazhdimin e seancës dëgjimore të mbajtur me datë 24.02.2022, konstatoi se gjyqtari Konxheli, me rastin e procedimit të çështjes penale të evidentuar me numër PKR.nr.35/15, ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7, të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe pika 5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

Këshilli ka gjetur se gjyqtari Konxheli është përfshirë në shkelje disiplinore të pretenduara nga Autoriteti Kompetent për shkak të mos procedimit më tutje të lëndës penale PKR.nr.35/15. Lëndën në fjalë, gjyqtari Konxheli e kishte pranuar më 06.03.2015. Seancën e parë për këtë çështje penale e kishte caktuar më 02.02.2016, ndërsa deri më 26.01.2017, ai nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim tjetër. Në bazë të urdhëresës së lëshuar nga gjyqtarit Konxheli, më 26.01.2017 Stacioni Policor në Zveçan kishte kthyer përgjigje duke njoftuar Gjykatën Themelore në Ferizaj se i pandehuri G.P. nga pas lufta jeton në Mitrovicë, dhe se adresa është zonë e përgjegjësisë së Stacionit të Policisë Jugu në Mitrovicë. Kërkesë të njëjtë gjyqtari Konxheli kishte dërguar edhe në Stacionin e Policisë në Ferizaj për të vërtetuar vendqëndrimin e të pandehurit A.S, dhe ishte njoftuar nga policia se i pandehuri A.S. është nga Ferizaj, por ai së bashku me familjen e tij tani jeton në Suedi.

Këshilli e ka parasysh se gjyqtari Konxheli nga data 15.03.2017 deri më 01.07.2019 ka qenë i përzgjedhur si gjyqtar mbikëqyrës i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Shtërpçë. Ndërsa, më 01.07.2019, gjyqtari Konxheli ka kaluar në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Special. Po ashtu, Këshilli është në dijeni që gjyqtari Konxheli ka qenë i ngarkuar me një numër të madh të lëndëve të rënda penale. Megjithatë, mosndërmarrja e asnjë veprimi përveç caktimit të seancës së parë, që përfshinë periudhën nga 02.02.2016 deri më 01.07.2019, kur gjyqtari Konxheli ka kaluar në gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, lidhur me lëndën me numër PKR.nr.35/15, sipas vlerësimit të Këshillit paraqet neglizhencë nga ana e gjyqtarit Konxheli.

Këshilli ka vlerësuar se sjellja e gjyqtarit Konxheli përbën shkelje sipas nenit 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7, të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në dispozitën 5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar është përcaktuar se “gjyqtari mban nivel të lartë të aftësive profesionale dhe ushtron funksionin e tij në mënyrë profesionale, të përgjegjshme dhe efikase”. Në pikën 5, paragrafi 5.1, të dispozitës 5 të Kodit të cituar më lartë është përcaktuar se “funksioni i gjyqtarit ka prioritet kundrejt të gjitha aktiviteteve tjera të gjyqtarit”, ndërsa paragrafi 5.2 përcakton se “Gjyqtari është i detyruar ta organizoj punën brenda orarit të punës me qëllim të shfrytëzimit të plot dhe efikas të orarit të punës”.

Përgjegjësitë e gjyqtarit që lidhen me sjelljen e tij si dhe në promovimin e besimit të publikut ndaj gjyqësor rrjedhin nga dispozitat e Kodit të Etikës. I njëjti Kod sqaron se gjyqtari duhet të ruajë dhe promovojë integritetin e figurës së gjyqtarit. Në rastin konkret vlerësohet se gjyqtari Konxheli me sjelljen e tij ka konsumuar të gjitha elementet e shkeljeve etike.

Shkeljet e sipër theksuara janë provuar me provat e administruara, të cilat i janë prezantuar Këshillit nga raporti fakt mbledhës i Panelit Hetimor. Ky raport është vlerësuar si i besueshëm pasi Paneli, në mënyrë objektive dhe sipas procedurës së përcaktuar ligjore, ka zhvilluar procesin e hetimit të çështjes dhe konstatimit të fakteve. Këshilli i ka vlerësuar pretendimet e subjektit të hetimit, por ka gjetur se në kuptim të fakteve të konstatuara me provat e administruara, këto pretendime dhe deklarata nuk kanë ndikuar që Këshilli të marr një vendim tjetër.

Masa disiplinore, e shqiptuar sipas vlerësimit të Këshillit, është masë proporcionale me shkeljen e konsumuar nga ana e subjektit të hetimit, duke siguruar kështu zbatimin e përgjegjësive ligjore që ka Këshilli Gjyqësor në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarëve, e cila procedurë bazohet në Ligjin për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Sipas Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, masa disiplinore duhet të jetë e tillë që të ndikojë tek gjyqtari që është subjekt i hetimit me qëllim të korrektimit të veprimeve të tij/saj gjatë ushtrimit të funksionit në të ardhmen.

Nga sa u tha më lartë, bazuar në nenin 7, paragrafi 1, pika 1.2, dhe paragrafi 2, pika 2.5, të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës**  
**KGJK.nr.102/2022, datë: 24 shkurt 2022**



Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

#### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve nga pranimi i vendimit.

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- *Albina Shabani Rama, Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë;*
- *Musa Konxheli, Gjyqtar i Gjykatës Themelore në Prishtinë;*
- *Arkivit.*